- 4.2 Qiramarrësi mund të kontrakttoj partner tjerë nënkontraktues dhe i njëjti obligohet që për marrëveshjen e arritur ta njoftoj qeradhënësin në afat prej 30 ditësh.
- 4.3 Autoriteti kontraktues (Qiradhënsi) nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.
- 4.4 Qiramarrësi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e nënkontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Qiramarrësin nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5.

Ndihma lidhur me rregulloret vendore

- 6.1 Qiramarrësi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Qiramarrësin gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta jap ndihmën e kerkuar nga qiramarrësi.

Neni 6.

Obligimet e përgjithshme të Qiramarrësit

- 6.1 Qiramarrësi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin qiramarsit për ndonjë dem.
- 6.2 Qiramarrësi duhet të veprojë sipas urdhërave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Qiramarrësi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhërit. Ekzekutimi i urdhërit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.
- 6.3 Qiramarrësi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.
- 6.4 Qiramarsit duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si

private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalojë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

- 6.5 Nëse Qiramarrësi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

**Neni 7.
Siguria e ekzekutimit:**

Nuk aplikohet.

**Neni 8.
Sigurimi:**

Sigurimi i tenderit është 35.000 Euro.

- 8.1 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Qiramarrësit sipas Nenit 8.1, Qiramarrësi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

**Neni 9.
Programi i realizimit**

- 9.1 Nëse kërkohet në KVK, Qiramarrësi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përmbajë siq është cekur më lartë.

**Neni 10.
Periudha e ekzekutimit të detyrimeve**

- 10.1 Periudha e ekzekutimit të detyrimeve kontraktuale do të fillojë sipas dinamikës së realizimit të kësaj kontrate (sipas fazave dhe afateve të prezentuara nga Qiramarrësi).

**Neni 11.
Parimet të përgjithshme të pagesave**

- 11.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i bëjë qiradhënësi sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.
- 11.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Qiradhenjesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson qiramarrësi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.
- 11.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 15 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.
- 11.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 5.3 do t'i japin të drejtë Qiradhenjesit (AK) që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh nga Autoriteti kontraktues.

**Neni 12.
Dorëzimi**

- 12.1 Qiramarrësi duhet t'i dorëzojë pronën e marrur me qira dhe Kompleksin e ndërtuar në këtë pronë pas skadimit të kontratës Qiradhënësit (KK-Pejë) në pajtim me dispozitën e nenit 2 pika 2.7 të kësaj kontrate.

- 12.2 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i pronës është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

Neni 13.

Shkelja e kontratës:

- 13.1 Për mos-realizimin e kontratës mund të bëhet shkeputja e kontratës nga A.K.KK-Pejë.
- 13.2 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të kryej ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.
- 13.3 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:
- a) dëmet; dhe/ose
 - b) ndërprerjen e kontratës.
- 13.4 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:
- a) dëme të përgjithshme; ose
 - b) dëme të likuidueshme.

Neni 14.

Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

- 14.1 Qiradhënësi mundet që, pasi t'i japë Qiramarrësit dy muaj paralajmërim (afati denoncues), ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:
- a) kur Qiramarrësi në mënyrë përmbajtësore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
 - b) kur Qiramarrësi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;
 - c) kur Qiramarrësi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
 - d) kur Qiramarrësi tërhiqet vet nga kjo kontratë dhe ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa leje nga Qiradhënsi kontraktues;
 - e) kur Qiramarrësi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykata, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislationin apo në rregulloret nacionale;
 - f) kur Qiramarsin është dënuar për një shkelje të rëndë, që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
 - g) kur Qiramarsin është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
 - h) kur Qiramarrësi i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të komunitetit;

- i) kur Qiramarrësi , pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
 - j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Qiramarrësi, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
 - k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
 - l) kur Qiramarrësi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.
- 14.2 Ndërprerja e kontratës nga Qiradhënsi mund të bëhet vetëm kur Qiramarrësi nuk përmbush kontratën. Qiradhënsi pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë. Detyrimi i Qiramarrësit për të shtyrë përmbushjen duhet të pushojë së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.
- 14.3 Qiradhënsi, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Qiramarrësin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e punëve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.
- 14.4 Në rast të ndërprerjes Qiradhënsi, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Qiramarrësit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi punët e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të punës të realizuar.

Neni 15.

Ndërprerja nga ana e Qiramarrësit

- 15.1 Qiramarrësi , pasi e ka paralajmëruar Qiradhënsin **dy muaj** paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse:
- Qiradhënsi, gjegjësisht institucionet komunale nuk ia lëshojë lejet ndërtuese që kërkojnë ligjet ose rregulloret Qiramarrësit në afatin minimal, gjegjësisht sipas afatizimeve ligjore dhe rregulloreve përkatëse të Komunës së Pejës.
 - vazhdimisht Qiradhënsi nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura;
 - institucionet shtetërore nuk i japin lejet dhe licencat e domosdoshme Qiramarrësit për realizim të projektit, ose
 - e pezullon dorëzimin Qiradhënsi, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Qiramarsit
- 15.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Qiradhënsit dhe Qiramarrësit.
- 15.3 Në rast të ndërprerjes së tillë, Qiradhënsi do ta paguajë Qiramarrësit për humbje ose dëmet që mund t'i jenë shkaktuar Qiramarrësit.

Neni 16.

Forca madhore

- 16.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga

- një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.
- 16.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "*forcë madhore*" do të thotë veprimet e Zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.
- 16.3 Pa marrë parasysh dispozitat e lartëcekura, Qiramarrësi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e cekura, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Qiramarsi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.
- 16.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Qiramarsi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Qiramarsi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.
- 16.5 Nëse Qiramarsi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit të cekura shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 17.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve përmes bisedimeve

- 17.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
- 17.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 18.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

- 18.1 Në rast të ndonjë kontesti eventual lidhur me këtë kontratë palet të njëjtin do të tentojnë ta zgjedhin përmes bisedimeve, në të kundërtën kompetente është Gjykata Komunale në Pejë.

18.2. Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në gjashtë kopje origjinale, tri prej të cilave janë për Qiradhënësin dhe tri për Qiramarrësin.

Për Qiradhënësin

Për Qeramarrësin

Emri:	Dr. Ali Berisha	Emri:	Isak Xhemali
Pozita:	Kryetar i KK-Pejë	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.01.2012	Data:	26.01.2012
Emri	Xhemë Berisha	Vula:	
Pozita:	Menaxher i prokurimit	Pozita:	
Nënshkrimi		Data:	
Vula			



L.Veterniku, p.n.
Prishtinë Kosovë
mob: +377 44 151 959
mob: +386 49 173 396
tel: +381 38 551 891
fax: +381 38 551 893

- Projekti ideor -

për

**NDERTIMIN E FSHATIT TURISTIK MALOR
NË FSHATIN KUQISHTE TE RUGOVËS SE PEJËS**

Pronar dhe investitor: EKO COMPANY sh.p.k.

**(Me këshillim profesional nga Kompania "Hoilbraaten Consultin" / Oslo, Norvegji dhe
Drejtoria e Turizmit e Komunës se Pejës.)**

Pejë / 2009

PËRMBAJTJA

PREZANTIM I KOMPANISE	3
PROJEKTI NË PIKA TË SHKURTËRA	4
• Plani i punës në faza	
QËLLIMI I PROJEKTIT	4
DREJTIMET STRATEGJIKE AFATMESME DHE AFATGJATA	4
BUXHETI I INVESTIMEVE	5
AKTIVITETET TJERA	5
NDIKIMI NË AMABIENT	6
NDIKIMI EKONOMIK	6
• Krijimi i bizneseve familjare	
• Punësimi në këtë qendër turistike	
TREGU TURISTK	6
• Synimi i tregut Vendor - Internacional	
• Tërheqja e tregut	
• Synimi i tregut internacional	
• Grupmoshat e synuara	
KAPACITETI AKOMODUES	5
PRODUKTI TURISTIK	6
MARKETING	9
• Buxheti për promovim	
• Konkurenca	
BASHKPUNIMET	9
• Bashkpunimi me K.K. Pejë	
• Bashkpunimi me komunitetin lokal të Rugovës	
• Bashkpunimi ndërkufitarë	
PËRMBLEDHJE	10

DREJTIMET STRATEGJIKE AFATMESME DHE AFATGJATA

Kompania e cila do të bëjë investimet në fshatin turistik Kuqishtë në strategjinë afatmesme ka për synim krijimin e një ambienti turistik, i cili do të ndikoj në tërheqjen e klienteles vendore (shqiptarëve, kosovarëve dhe të huajve) dhe gjatë kësaj kohë do të ndikoj përmes marketingut të sajë në ngritjen e imazhit të mirë regjionit malorë të Rugovës si destinacion turistik.

Ndërsa sa i përket strategjisë afatgjate kompania ka për synim krijimin e një fshati me përmasa ndërkombëtare, i cili do të jetë konkurrent në regjion dhe Evropë. Kështu që, përmes lidhjeve që ka në tregun turistik ndërkombëtar, kompania do të shfrytëzoj këtë mundësi që të tërheq edhe tregun ndërkombëtarë.

BUXHETI I INVESTIMEVE

Në fazën aktuale të planifikimeve parashihen të investohen rreth 4 (katër) milionë euro. "EKO Company sh.p.k." ka siguruar mjete bazë vetanake prej 2 (dy) milionë eurove, të cilat i kanë të gatshme në xhirollogari e tij pranë ProCredit Bank bashkë-ortaku Isak Xhemaili, ndërsa mjetet tjera do i sigurojë përmes bankave dhe donatorëve, të cilët po e mirëpresin kreditimin e projekteve tona (ProCredit Bank ka bërë për këtë qëllim edhe një prononcim me shkrim, i cili është bashkangjitur kërkesës sonë).

AKTIVITETET TJERA

Pos objekteve hoteliere dhe gastronomike, me vonë edhe pistës së skijimit, kompania jonë ka në plan që në këtë hapsirë të ndërtohen edhe salla për konferenca dhe seminare, duke i konkurruar Strugën dhe Ohrin, ku aktualisht po mbahen shumica e seminareve trajnuese kosovare. Këto ambiente do t'i shërbenin edhe afirmimit të turizmit të këtij rajoni, duke përgatitur kuadrin

profesional për këtë branshë. Jemi thellësisht të bindur se përmes projekte tona regjioni i Pejës do afirmohet, duke u bërë atraksionin turistik. Këtij atraksioni do ia rris vlerat projektimi i një si parku edukativ e kologjik, duke e organizuar një eco-muze, i cili do të shërbejë jo vetem për turistët por edhe për ekskursionet edukative që do t'i bëjmë me shkolla. Pastaj parashikohet prodhimtaria artizanale të ekspoziteve përkatëse të zonës, si dhe ekspozimet e tyre që do i prodhojnë edhe prodhuesit tjerë. Kjo veprimtari do të jetë një shtytje e mirë për zhvillimin e ekonomive familjare për banorët lokal. Pos kësaj veprimtarie, parashihet edhe organizimi i prodhimitarisë tradicionale të bulmetrave, duke ofruar një minitreg sanitar për për pasimin e bulmetrave vendore që do të ofron kryesisht popullsia lokale. Gjithësesi këtij fshati turistik malor nuk do t'i mungojnë as mini-kopshtet zoologjike dhe botanike, për t'u ofruan fëmijëve të regjionit dhe të Kosovës që t'i vizitojnë ato. Dhe për t'i realizuar të gjitha këto ide, do t'u ofrojmë mundësi edhe investuesve të tjerë kooperues në fusha të veçanta, duke ua ofruar parakushtet e përshtatshme infrastrukturore. Sigurisht, një kompleks i tillë do të ketë mundësi të mira që nxënësit dhe studentët të kryejnë praktikën profesionale, kryesisht në fushën e turizmit malor.

Sa për ilustrim të interesimit, po sjell një shembull: Prof. Dr. Halil Ahmetaj, është duke hartuar një ide për ndërtim të një sanatorumi për rehabilitim shëndetësor të atyre që kanë probleme me frymëmarrje dhe mungesë të rruzave të kuqe të gjakut, meqë, si njohës i mirë i ambientit ku parashihet të ngritet ky kompleks dhe si specialist përkatës, e vlerëson pozitën natyrore si tepër të favorshme për një sanatorium rehabilitues.

NDIKIMI NË AMBIENT

Sa i përket ndikimit në mjedis në bazë të projektit që do të punohet, kompleksi do t'u përshtatet kushteve ambientale më qëllim që të mos ndikoj në shkatërrimin e tij, sepse është në interes edhe të vetë biznesit sa më të suksesshëm. Në vitet e fundit shijet dhe ofertat turistike kanë filluar të ndryshojnë, meqë vizitorët tanimë janë duke kërkuar vende aventurash që janë ngushtësisht të lidhura me përshtatjen e natyrës, gjegjësisht ambientit sa më ekologjik, prandaj edhe qendra do të punohet duke respektuar gjithnjë natyrën, gjegjësisht ambientin rrethor. Njëherit në planin e zhvillimit të qendrës do të projektohen edhe projekte për mbrojtje të ambientit.

PROJEKTI NË PIKA TË SHKURTËRA

- **Plani i punës në faza**

Realizimi i këtij projekti do të zhvillohet në faza.

Në fazën e parë parashihet ndërtimi i infrastrukturës; rrjeti elektrik, kanalizimi i ujërave të zeza, teleferiku dhe rruga deri te Guri i Kuq. Njëherit planifikohet të ndërtohet një mini-hidrocentral, i cili do kompensojë mungesën e rrymës elektrike në Rugovë. Për projekt përkatës janë angazhuar firma profesionale dhe sapo ato të përfundojnë punën e tyre, to paraqitet institucioneve kompetente qeveritare për marrje të lejes. Kjo fazë mund të zgjat deri në një vit, varësisht nga kushtet atmosferike.

Në fazën e dytë parashihet ndërtimi i shtëpizave, përgatitja e terreneve sportive, vend-kampingut, si dhe ndërtimi i objekteve përcjellëse afariste, i cili parashihet të përbyllet në vitin e dytë të ndërtimit.

Në fazën e tretë parashihet finalizimi – përfundimi final i tërë projektit, i cili parashihet në vitin e tretë të ndërtimit.

QËLLIMI I PROJEKTIT

Krijimi i një fshati turistik malor, gjithnjë duke respektuar ambientin, do të ishte nxitës i zhvillimit ekonomik dhe të turizmit në Komunën e Pejës, njëherit do t'i kontribuonte dukshëm në krijimin e një imazhi pozitiv për turizmin malor në Komunën e Pejës, i cili, sidomos në Bjeshkët e Rugovës i ka kushtet fantastike natyrore. Ky fshat turistik malor do të nxiste bizneset familjare të kësaj larmie, duke rritur punësimin të banorëve lokalë.

NDIKIMI EKONOMIK

- **Krijimi i bizneseve familjare.**

Fshati turistik do të jetë motor i zhvillimit të ekonomisë, jo vetëm të Regjioni malor të Rugovës, por do të ndikojë në të gjithë komunën e Pejës dhe më gjerë. Sa i përket ndikimit në komunën e Pejës fshati turistik përmes ofertave të tij do të ndikojë në shtimin e lëvizjeve turistike në Komunën e Pejës, gjë që do të ndikojë edhe në rritje të të hyrave fitimprurëse për vetë kompleksin tonë dhe për bizneset tjera përkatëse të Komunës. Ndërsa sa i përket regjionit malor të Rugovës qendra turistike do të jetë një pikë grumbullimi i të gjitha të mirave ushqimore që do të prodhojnë familjet lokale nga Rugova, pra do të jetë edhe nxitës që banorët lokal të ofrojnë produkte të ndryshme ushqimore e artizanale.

- **Punësimi në këtë qendër turistike**

Punësimi do të bëhet nëpër faza, duke ju përshtatur zhvillimit të projektit të kompleksit gjatë 3 viteve:

Në fazën e parë parashihet të jenë të punësuar 24 veta.

Në fazën e dytë parashihet të jenë të punësuar edhe rreth 25 veta.

Në fazën e tretë, përfundimtare, parashihen të jenë të punësuar gjithsej mbi 100 veta, profesionalistë dhe punëtor, me përqendrim ruajtje, menaxhim dhe mirëmbajtje të kompleksit dhe të ambientit rreth e rrotull.

Përveç punësimit të përhershëm Firma jonë do të bëjë marrëveshje edhe me guidat malorë që do të përfitonin nga shëtitjet që ata i organizojnë për turistët. Pra do të jetë edhe kjo një mënyrë e gjetjes së punëve për banorë e Pejës.

TREGU TURISTIK

- **Synimi i tregut Vendor - Internacional**

Në strategjinë afatmesme të qendrës tonë turistike në Kuqishtë orientimi jonë do të jetë më tepër i bazuar në tregun vendor. Është shumë fatkeqe që Kosova ende nuk ka një emër turistik në Evropë, prandaj edhe tregu turistik ndërkombëtar është, tani për tani, më i vështir për tu arritur, prandaj synimet tona në strategjinë afatmesme janë të orientuara më tepër në tregun afatmesëm, ndërsa në planin afatgjatë do të investohet më tepër në tërheqjen e tregut turistik internacional, duke i dhënë Pejës imazh dhe emër turistik evropian.

- **Nxitja e tregut**

Ofertat të cilat do të përpilohen do të jenë nxitëset më të mëdhenjë për tregun turistik në këtë anë. Po ashtu, përmes promovimeve të cilat do të bëhen përmes kanaleve të ndryshme mediatike, që do të thotë përmes marketingut profesional, shumë shpejt kompleksit tonë, Rugovës dhe Pejës do ua rrisim reputacionin, parakusht për rritje të tregut turistik.

- **Synimi i tregut turistik ndërkombëtar**

Kompania në programin e sajë afatgjatë ka planifikuar që përmes tour-operatorëve, me të cilët do të bashkëpunojë, do të bëjë promovimet e kompleksit dhe shitjen e ofertave. Për këtë qëllim, fillimisht do të synohet bashkëpunimi i ngushtë me agjencitë e specializuara turistike që i kanë në pronësi emigrantët shqiptarë në Evropë e në Sh.B.A. Në këtë drejtim, njohjet dhe lidhjet shumëvjeçare që ka Drejtori Ibrahim Kelmendi gjatë angazhimit të tij në Evropën Perëndimore, janë një favor i madh që këto të ndodhin që në fillim.

- **Grupmoshat e synuara**

Ofertat që do të ofrohen do të jenë të ndara në bazë të stinëve të vitit:

Oferta e sezonës së dimrit do të jetë e bazuar më tepër për skijim dhe aktivitete tjera alpine. shkollat e skijimit, aktivitete sportive, aktivitete aventuriere, etj.. të cilat do të ofrohen për grupmoshat që janë më vital (moshat 10 – 50 vjeçarë).

Oferta e sezonës së verës do të jetë më të shumta, pasi që në këto oferta do të kenë programe për të gjitha moshat, duke filluar nga fëmijët e deri në moshat e vjetra.

Oferta e sezonës së vjeshtës dhe pranverës do të jetë e bazuar më tepër në ekskursionet edukative me nxënës.

Prandaj me këtë kuptojmë se jemi të interesuar të punojmë me të gjitha moshat.

KAPACITETET AKOMODUESE

Numri i shtëpizave malore (që do u ngjasojë staneve tradicionale të vendit), fillimisht planifikohen të jetë 48 sish, si dhe objekti hotelier “Guri i Kuq” me kapacitetet e veta. Çdo shtëpizë do të ketë një kapacitet për 2-5 veta. Ato do të jenë të standardeve të larta evropiane, prandaj për këtë qëllim kemi jemi në bisedime me një firmë të specializuar gjermane që t’i projektojë e ndërtojë ato. Njëkohësisht po bisedohet edhe me një firmë të specializuar në Rozhajë, meqë, fatkeqësisht, për ndonjë firmë të specializuar vendore nuk jemi të informuar se ekzistojnë.

PRODUKTET TURISTIKE

Produktet turistike janë njëra nga çështjet më të rëndësishme për suksesin e kësaj qendre turistike, prandaj Firma jonë ka një përqëndrim më të madh në zhvillimin e tyre. Do të ofrohen aktivitete të ndryshme sportive - rekreative që do të jenë përbrenda qendrës, si terrenet për sportet e vogla (basketbolli, hendbolli, tenisi, kalërimi, etj.), të cilat do të shfrytëzohen si pika për ndikim të zhvillimit të produktit si produkte turistike. Qendra do të zhvilloj edhe aktivitete që janë të lidhura drejtë për drejtë me male, ujëra, kulturë dhe traditë vendore.

Produktet turistike që do t’u ofrohen turistëve do të jenë të lidhura ngushtë edhe më ofertat që ata do t’i shfrytëzojnë, si ato një-ditore deri në dhjetë-ditore, dhe produktet që do t’i kenë në dispozicion, janë:

- Ngjitje në shkëmbinj
- Pushtimin e majave malore
- Vizita e shpellave
- Ecje malorë ditore
- Ecje tematike
- Peshkimi i kontrolluar
- Flora dhe fauna
- Crossborder country me Malin e Zi dhe Shqipërinë
- Ekskursionë edukative

Të gjitha këto produkte turistike do të zhvillohen në bazë të planprogramit të zhvillimit të qendrës. Një ndër pikat interesante që do të jetë në zhvillimin e produktit turistik është se këto produkte do të kryhen nga guidat malore, të cilat do të krijonte edhe një mundësi të punësimit indirekt.

MARKETINGU

- **Buxheti për promovim**

Varësisht nga zhillimi i projektit, do të planifikohet edhe ndarja e buxhetit për marketing. Në fazën e parë të aktivizimit të kompletuar të kompleksit do të ndahen rreth 20% e buxhetit për marketing, pasi që në fillim plan-programi është i orientuar më tepër në ndërtimin dhe zhvillimin e produktit turistik dhe kapaciteteve njerëzore dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve. Mirëpo në vitet në vijim buxheti për promovim e marketing gjithnjë do të ngritet, pasi që promovimi është njëra ndër faktorët kryesor për suksesin e qendrës.

- **Konkurrenca**

Vetëkuptohet se konkurrenca është gjithnjë e pranishme në të gjitha tregjet, prandaj edhe në tregun e turizmit, por shërbimet me të cilat do t'i ofrojmë, jemi të bindur se në një afat të shkurtër

do të fitojmë tregun e Kosovës në përqindje të lartë. Ne nuk i frikësohemi konkurrencës dhe as nuk e nënvlerësojmë atë, por e trajtomë të mirëqenë, që nxit garën cilësore.

Në strategjinë afatgjate me zhvillimin e qendrës dhe përmes lidhjeve botërore që ka kompania norvegjeze “Hoibraaten Consulting”, do të jemi konkurrent edhe në rajon dhe më gjerë, pasi që jemi duke krijuar zinxhirin e fshatrave turistik në regjion dhe më gjerë.

BASHKEPUNIMET

- **Bashkëpunimi me K.K. Pejë**

Bashkëpunimi me Komunën e Pejës, kushtimisht Divizionin e Turizmit, do të zhvillohet në mënyrë permanente, në të gjitha lëmenjtë (marketing, zhvillim të produktit, etj.). Këto, gjithsesi, janë më leverdi të dyanshme. Nga ana jonë gatishmëria për bashkëpunim do të jetë e hapur dhe e përhershme, me shpresë se kjo nuk do t'u mungojë as strukturave përkatëse komunale. Në këto momente me kënaqësi duhet të pranojmë, se strukturat komunale po tregojnë gatishmëri këshillimesh profesionale e administrative për të realizuar kërkesën tonë, po shfaqin edhe gatishmëri përkrahjeje, meqë tashmë duket se e kanë kuptuar se këto janë tepër përmbajtjesore për të joshur sa më shpejt investitorë në Komunën tonë.

- **Bashkëpunimi me komunitetin lokal të Rugovës**

Bashkëpunimi me banorët vendor do të jetë i përhershëm, duke respektuar ofertat e tyre, qoftë të prodhimeve bujqësore e blegtorale, të artizanaleve, etj. Bashkëpunimi sa më përmbajtësor mundëson edhe zhvillimin më të mirë të qendrës dhe ngritjen e ekonomive familjare të banorëve lokal. Prandaj një bashkëpunim do të jetë i domosdoshëm. E që bashkëpunimi të jetë sa më i ngushtë e sa më produktiv, qysh në fillim do të kontribuoj bashë-ortaku i Familjes autoritare Dreshaj, e Fshatit Kuqishtë, ku e ka epiqendrën kompleksi ynë turistik. Për këtë dëshmon përvoja e deritanishme e kësaj Familjeje me kompleksin “Guri i Kuq”, në Leqinat të Kuqishtës.

- **Bashkpunimi ndërkufitarë**

Oferta ndërkufitare do të bëhet me Malin e Zi dhe Shqipërinë, meqë kufiri me këto shtete është shumë pranë kompleksit tonë turistik, duke krijuar edhe oferta të përbashkëta. Firma jonë është në bisedime me strukturat kompetente të Komunës së Plavës, që format e bashkëpunimit të konkretizohen sa më shpejt. Bile, ato struktura janë të gatshme t'i japin firmës sonë territore të asaj Komune, nëse ato do të na duhen për të zgjeruar kompleksin tonë.

PËRMBLEDHJE

Projekti jonë do të realizohet në fshatin Kuqishtë, në regjionin malor të Rugovës - 25km nga Peja, duke e integruar edhe kompleksin ekzistues "Guri i Kuq".

Në përgjithësi projekti ynë do të realizohet në 3 faza dhe do të përmbaj:

- Ndërtimi i infrastrukturës (rrugicat, rrjeti elektrik, kanalizimi i ujërave të zeza, vend-parkimi, teleferiku dhe rruga deri të kompleksi turistik "Guri i Kuq", në Leqinat, me synim që kjo rrugicë në të ardhmën e afërt të ndërtohet edhe deri të Liqeni (nëse do të jepet leje).

Faza e dytë do të përmbaj ndërtimin e shtëpizave, përgatitja e terreneve sportive, kamping-ut, si dhe ndërtimi i objekteve përcjellëse afariste.

Në fazën e tretë parashihet finalizimi – përfundimi final i tërë projektit, krijimi i ofertave dhe promovimi i tyre me qëllim të tërheqjes së turistëve në komunën tonë.

Investimet që do të bëhen në këtë kompleks do të jenë rreth 4 (katër) milionë eurove. Dhe deri në finalizimin e projektit 3-vjeçar do të ketë rreth 100 persona të punësuar.

Ky projekt përmes planit të sajë biznesor do të ndikoj në zhvillimin e turizmit dhe krijimit të bizneseve familjare duke i shlyer ato në prodhimin e agro-produkteve, gjë që do të ndikoj në të mirë të zhvillimit të regjionit dhe popullatës lokale.

Pra, në pika të shkurtra mund të quhet projekt nxitës i zhvillimit të turizmit fshatar malor dhe agro-turizmit, gjë që është edhe në ide dhe në planet e zhvillimit komunal dhe nuk bie ndesh ekosistemin hapësinor.

Përfundim

Duke u bazuar në potencialet turistike që i ofron ky regjion (sidomos Rugova) dhe duke u mbështetur në planet e zhvillimit komunal, ku turizmi dhe bujqësia kanë një prioritet në strategjinë e zhvillimit komunal, shpresoj në mirëkuptimin tuaj për ndihmën e kësaj iniciative investuese me interes të përbashkët për gjithë komunën e Pejës.

Për çdo informat dhe qartësim mund të kontaktoni në:

Tel: 044-153 385 ; 049-501 400 (Qerim Dreshaj) dhe 044-151059 (Ibrahim Kelmendi)

EKO Company sh.p.k.

Qerim Dreshaj
i. A. Qerim Dreshaj



Data: 30 / 08 / 2009

PS.

- *Këtij projekti ideor do t'i bashkangjitetën dëshmitë e pronësisë kadastrale të parcelave të kërkuara për shfytëzim,*
- *Kopjeskica e këtyre parcelave kadastrale,*
- *Shkresa e Firmës Holbraaten Consulting",*
- *Shkresa e ProCredit Bankës,*
- *Skica ideore, etj.*